



NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE 16 tetor - 6 nëntor 2006

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

1. Gjatë periudhës 16 tetor – 6 nëntor 2006 Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ka zhvilluar gjithsej 5 mbledhje. Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar. Në 6 mbledhje janë zhvilluar gjithsej 160 minuta punë efektive në komision ose mesatarisht 32 minuta për mbledhje.

2. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme, të propozuar nga Këshilli i Ministrave, në mbledhje të komisionit kanë qenë të pranishëm vetëm përfaqësues të qeverisë në mbrojtje të projektligjeve përkatëse. Në dy mbledhje ka qenë i pranishëm edhe Zëvendësministri i Ekonomisë. Edhe gjatë kësaj periudhe është konstatuar se vetëm një pjesë e deputetëve marrin pjesë në diskutime dhe debate. Gjatë monitorimit është konstatuar se deputetët, në përgjithësi, nuk janë të informuar paraprakisht për projek-

(Vijon në faqen 2)

RASTEVËZHGIMI Procesi i shqyrtimit të projektligjeve të veçanta

Projektligji "Për Mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit"

Projektligji "Për Mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" është depozituar në Kuvend më datë 01.08.2006 dhe është përshirë në programin e punimeve të Kuvendit më datë 7.09.2006. Ky projektligj është parqitur nga Qeveria me propozim të Ministrisë së Shëndetësisë. Është parashikuar që të shqyrtohet në kalendarin 3-javor të periudhës 25 shtator - 16 tetor 2006 dhe 16 tetor – 6 nëntor 2006.

Komisioni përgjegjës për shqyrtimin e këtij projektligji është Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë. Për këtë projektligj kanë dhënë mendim edhe Komisione të tjera si: Komisioni i Ekonomisë dhe Financave; Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut si dhe Komisioni për Veprimtarirë Prodhese, Tregtinë dhe Mjedisin. Mbledhja e parë me objekt shqyrtimin e këtij projektligji është zhvilluar më datë 9 tetor 2006 nga Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë. Nga ky komision janë zhvillu-

(Vijon në faqen 4)

Në këtë numër do të lexoni:

1. Nga Monitorimi i Veprimtarisë së Komisioneve Parlamentare për periudhën 16 tetor - 6 nëntor 2006

faqe 1-3

2. Raste vëzhgimi: Procesi i shqyrtimit të projektligjeve të veçanta

faqe 4

3. Pjesë nga Raporti i Progresit për Shqipërinë i Komisionit European 2006

faqe 5-7

4. Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave për muajin nëntor 2006

faqe 8-9

5. Projektligje në proces Projektligji "Për Miratimin e Formës dhe të Formulës së Privatizimit të INSIG SHA-së"

faqe 9-10

6. Kalendarit 3 javor i Kuvendit të Shqipërisë

6 - 27 nëntor 2006

faqe 11-13

KALENDAR I

3 Javor (6-27 nëntor 2006) i Punimeve të Kuvendit Sesioni i III-të, Legjislatura e XVII-të

E Hënë, datë 6.11.2006, ora 17.⁰⁰

- Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare, datë 2.11.2006.
3. Miratimi i Programit të Punës së Kuvendit 6 Nëntor – 28 Dhjetor 2006.
4. Miratimi i Kalendarit 3 javor të punimeve të Kuvendit.

(Vijon në faqen 11)

NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE

16 tetor - 6 nëntor 2006

(Vijon nga faqja 1)

tligjet me objekt ratifikim marrëveshesh ndërkombëtare dhe nuk kërkojnë informacion për detyrimet që rrjedhin nga ky dokument. Për projektligje të veçanta siç është rasti i projektligjit "Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë" dhe projektligjit "Për disa ndryshime në Ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" është konstatuar se deputet kanë qenë të informuar. Në 5 mbledhje të realizuara numërohen rreth 15 diskutime të zhvilluara nga deputetët. Gjithashtu janë propozuar 5 amendamente gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme.

3. Edhe gjatë kësaj periudhe janë konstatuar mungesa të shumta të deputetëve. Gjithashtu deputetët vazhdojnë të vijjnë me vonesë në mbledhje dhe si rrjedhojë edhe mbledhjet fillojnë me vonesë. Edhe gjatë zhvillimit të mbledhjes deputetët largohen para përfundimit të saj. Gjatë monitorimit është konstatuar se numri i deputetëve të pranishëm në mbledhje është më i vogël se numri i deputetëve të pasqyruar në procesverbal. Edhe gjatë kësaj periudhe janë konstatuar raste kur deputetët vetëm sa kanë firmosur prezencën dhe janë larguar përsëri ndërkohë që mbledheja ka vazhduar normalisht. Gjatë kësaj periudhe nuk është zhvilluar asnjë seancë dëgjimore me grupe interesi ose subjekte të tjera joqeveritare si dhe nuk janë zhvilluar veprimtari të tjera kontrolluese. Nuk është bërë asnjë studim, vlerësim ose ndonjë raport kontrolli.

4. Mbledhjet kanë qenë të hapura. Të pranishëm kanë qenë edhe media.

Disa vlerësime: Siç rezultojnë nga monitorimi edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka një pjesëmarrje të rregullt të deputetëve në mbledhjet e komisionit. Deputetët vijjnë me vonesë dhe largohen përpara mbylljes së mbledhjes. Gjithashtu, nga verifikimi i procesverbalit dhe informacionit të marrë gjatë monitorimit rezultojnë se numri i deputetëve që mungojnë është më i madh se ai i paqyruar në procesverbal. Përsa i përket informimit paraprak të deputetëve për projektligjet është konstatuar se deputetët informohen paraprakisht vetëm për projektligjet e rëndësishme. Nuk rezultojnë një pjesëmarrje aktive e deputetëve në çështjet që diskutohen në komision. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve nuk ka patur ekspertizë tjetër përveç informacionit të marrë nga relacionet e projektligjeve si dhe ekspertët e qeverisë. Mbështetja e Komisionit, gjatë shqyrtimit të çështjeve, vetëm në burimin e informacionit të qeverisë pengon komisionin për të bërë një vlerësim më të gjerë të çështjeve nga shumë këndvështrime dhe duke konsultuar burime të ndryshme.

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave

1. Gjatë periudhës 16 tetor – 6 nëntor 2006 Komisioni i Ekonomisë dhe Financave ka zhvilluar gjithsej 7 mbledhje. Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar dhe janë realizuar të gjitha sipas datave të caktuara. Në mbledhjen e datës 1 nëntor është ndryshuar objekti i mbledhjes. Kohëzgjatja e mbledhjeve varion nga 5 deri në 75 minuta. Në 7 mbledhje janë zhvilluar gjithsej 325 minuta punë efektive në komision ose mesatarisht 46 minuta për mbledhje.

2. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme në mbledhje të komisionit kanë qenë të pranishëm vetëm përfaqësues të qeverisë në mbrojtje të projektligjeve përkatëse. Nuk është shfrytëzuar ndonjë ekspertizë ose burim tjetër, gjatë mbledhjeve të zhvilluara. Në mbledhjet e zhvilluara ka pasur debate po nga të njëjtët deputetë të cilët janë aktivizuar gjatë muajit shatator – tetor. Pjesa tjetër e deputetëve kanë qenë përgjithësisht pasiv ose janë

mjaftuar me ndonjë pyetje drejtuar specialistëve të qeverisë. Në 7 mbledhje të realizuara numërohen rreth 36 diskutime nga deputetët. Gjithashtu janë propozuar 11 amendamente kryesisht teknike. Është konstatuar se më shumë diskutime dhe debate zhvillohen për projektligjet që kanë një interes më të madh politik. Pjesa më e madhe e deputetëve nuk kanë informacion paraprak për projektligjet e shqyrtuara në komision. Ky fakt kuptohet nga mënyra e zhvillimit të diskutimeve dhe nga përmbajtja e pyetjeve që deputetët u drejtojnë specialistëve të qeverisë.

3. Krahasuar me periudhën e mëparshme gjatë këtyre tre javëve është konstatuar një pjesëmarrje më e lartë e deputetëve në mbledhje mesatarisht kanë qenë të pranishëm 15 deputetë për mbledhje nga 17 që ka gjithsej komisioni. Gjithashtu është konstatuar edhe një rritje e kohëzgjatjes së mbledhjeve.

4. Gjatë kësaj periudhe nuk është zhvilluar asnjë seancë dëgjimore si dhe nuk janë zhvilluar veprimtari të tjera kontrolluese me përjashtim të një një konference me temë "Prokurimet publike një hap i rëndësishëm drejt Integritetit Europian" në ambjentet e Hotel "Sheraton". Nuk është bërë asnjë studim, vlerësim ose ndonjë raport kontrolli.

5. Mbledhjet kanë qenë të hapura. Të pranishëm kanë qenë edhe media. Më datë 25.10.2006 Komisioni zhvilloi një takim me detyrues të mbyllura me përfaqësues të misionit të FMN-së në Shqipëri me objekt të ardhurat në Shqipëri për buxhetin e vitit 2007.

Disa vlerësime: Gjatë monitorimit të këtyre tre javëve krahasuar me periudhën e mëparshme është konstatuar një pjesëmarrje më e lartë e deputetëve në mbledhje mesatarisht kanë qenë të pranishëm në mbledhje 15 deputetë si dhe një rritje e kohëzgjatjes së mbledhjeve. Gjatë këtyre mbledhjeve janë shqyrtuar projektligje të rëndësishme si ai "Për Prokurimin Publik" si dhe ka filluar të shqyrtohet edhe projektligji "Për buxhetin e shtetit". Siç rezultojnë nga monitorimi janë zhvilluar shumë diskutime dhe janë propozuar edhe më shumë amendamente se në punimet e dy kalendareve të para të këtij sesi. Megjithatë debatet, diskutimet si dhe amendamentet janë bërë nga të njëjtët deputetë, ndërsa pjesa tjetër e deputetëve vazhdojnë të qëndrojnë pasiv. Edhe pse janë shqyrtuar projektligje të rëndësishme, siç u përmend dhe më sipër, konstatohet se deputetët mbështeten vetëm në burimin e informacionit të qeverisë. Edhe gjatë kësaj periudhe në mbledhjet e komisionit nuk kanë marrë pjesë grupet e interesit me përjashtim të mbledhjes së datës 18.10.2006 e cila është zhvilluar në formën e një konference me temë "Prokurimet publike një hap i rëndësishëm drejt Integritetit Europian" në ambjentet e Hotel "Sheraton".

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

1. Gjatë periudhës 16 tetor – 6 nëntor 2006 Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ka zhvilluar gjithsej 4 mbledhje. Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar. Më datë 3 nëntor kohëzgjatja e mbledhjes ka qenë 2 orë, më datë 24 tetor 1 orë e 30 min., ndërsa në dy mbledhjet e tjera nga 20 dhe 30 minuta. Gjithsej janë zhvilluar 250 minuta punë efektive në komision, mesatarisht 63 minuta për mbledhje.

2. Në përgjithësi gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme në mbledhje të komisionit kanë qenë të pranishëm vetëm përfaqësues të qeverisë në mbrojtje të pro-

(vijon në faqen 3)

NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE

16 tetor - 6 nëntor 2006

(Vijon nga faqja 2)

jektligjeve përkatëse. Në mbledhjen e datës 24 tetor 2006 me objekt shqyrtimin e projektligjit "Për Akademinë e Shkencave" komisioni ka zhvilluar një seancë dëgjimore ku kanë qenë të pranishëm përfaqësues të Akademisë së Shkencave. Gjatë monitorimit është konstatuar se vetëm një pjesë e deputetëve marrin pjesë në diskutime dhe debate. Në 4 mbledhje të realizuara numërohen rreth 8 diskutime të cilat janë zhvilluar kryesisht gjatë diskutimit të projektligjit "Për Buxhetin". Gjatë këtyre mbledhjeve nuk janë bërë amendamente.

3. Në 4 mbledhje të zhvilluara janë konstatuar mungesa të deputetëve në mbledhje. Mesatarisht kanë munguar 4 deputetë për mbledhje.

4. Gjatë kësaj periudhe është zhvilluar një seancë dëgjimore më datë 24 tetor 2006 me objekt shqyrtimin e projektligjit "Për Akademinë e Shkencave" ku kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësues të Akademisë së Shkencave. Nuk është bërë asnjë studim, vlerësim apo ndonjë raport kontrolli.

Disa vlerësime: Krahasuar me periudhat e tjera gjatë këtyre tre javëve në këtë komision është konstatuar një rritje e kohëzgjatjes së mbledhjeve. Kjo ka ndodhur edhe për faktin se gjatë këtyre mbledhjeve janë diskutuar projektligje të rëndësishme. Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar. Në përgjithësi edhe në këtë komision konstatohet se deputetët gjatë shqyrtimit të projektligjeve mbështeten kryesisht vetëm në ekspertivën e qeverisë dhe relacionin e projektligjit. Ndërsa në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 24 tetor 2006 me objekt shqyrtimin e projektligjit "Për Akademinë e Shkencave" ku kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësues të Akademisë së Shkencave gjatë diskutimeve dhe kundërshtimeve të bërë prej tyre deputetët kanë pranuar një sërë vërejtjesh dhe kanë rënë dakord për të ndryshuar projektligjin. Ky projektligj është akoma në proces shqyrtimi. Shembulli i mësipërm tregon qartë, se prania e grupeve të interesit si dhe e subjekteve të ndryshme, të cilat bëjnë oponencë, ofrojnë ekspertizë dhe japin alternativa, krijon më shumë mundësi për deputetët për të marrë vendime të drejta dhe më të matura.

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

1. Gjatë periudhës 16 tetor – 6 nëntor 2006 Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka zhvilluar gjithsej 4 mbledhje. Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar por nuk janë respektuar datat për zhvillimin e tyre. Objekti i mbledhjeve ka qenë i parashikuar dhe nuk është ndryshuar. Në 4 mbledhje janë zhvilluar gjithsej 320 minuta punë efektive në komision ose mesatarisht 80 minuta për mbledhje.

2. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme, të propozuar nga Këshilli i Ministrave, në mbledhje të komisionit kanë qenë të pranishëm përfaqësues të qeverisë në mbrojtje të projektligjeve përkatëse si dhe përfaqësues të grupeve të interesit. Në mbledhjen e datës 30 tetor me objekt shqyrtimin e projektligjit "Për Dhomat e Tregtisë" dhe projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8618 "Për Telekomunikacionin në Republikën e Shqipërisë" në mbledhje kanë qenë të pranishëm Ministri i Ekonomisë, zëvendësministri, kryetari i Dhomës së Tregtisë, përfaqësues të ERT-së dhe të dy kompanive të telefonisë së lëvizshme. Gjatë kësaj periudhe është konstatuar se një pjesë e deputetëve janë pasiv dhe nuk marrin pjesë në debate dhe diskutime. Në 4 mbledhje të realizuara numërohen 19 diskutime të zhvilluara nga deputetët. Gjithashtu janë propozuar 3 amendamente të

cilat kanë qenë të natyrës teknike. Edhe diskutimet e bërë janë kryesisht pyetje të deputetëve drejtuar specialistëve, debate dhe opinione për çështje të veçanta gjatë shqyrtimit të projektligjeve.

3. Edhe në këtë komision janë konstatuar mungesa të deputetëve në mbledhje. Mesatarisht mungojnë 4 deputetë për çdo mbledhje. Gjithashtu është konstatuar mungesa e përsëritur e ndonjë deputeti. Në 4 mbledhjet e zhvilluara jo në pak raste deputetët kanë ardhur me vonesë dhe janë larguar pa përfunduar mbledhja.

4. Mbledhjet kanë qenë të hapura. Të pranishëm kanë qenë edhe media. Nuk ka patur pengesa për të marrë pjesë në mbledhje. Ka vështirësi në marrejen e informacionit lidhur me procesverbalet si dhe raportet e komisionit, por kjo ndodh edhe për shkak të zbardhjes me vonesë të procesverbalet.

Disa vlerësime: Siç rezulton nga monitorimi krahasuar me komisionet e tjera Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka zhvilluar mbledhje me kohëzgjatje ka qenë relativisht me gjatë se në komisionet e tjera. Gjithashtu është konstatuar një pjesëmarrje më e gjerë duke përfshirë edhe grupet e interesit. Objekti i punës që ka ky komision si dhe projektligjet që shqyrton ngjallin një interes të veçantë sidomos të biznesit i cili është i pranishëm në mbledhjet e këtij komisioni. Edhe në këtë komision gjatë kësaj periudhe janë konstatuar mungesa të deputetëve. Jo të gjithë deputetët marrin pjesë në diskutime. Më datë 31.10.2006 gjatë shqyrtimit nën për nën të projektligjit "Për Dhomat e Tregtisë" deputetët e opozitës janë larguar nga mbledhja. Nërkohe komisioni ka vazhduar punën normalisht duke e miratuar projektligjin me disa ndryshime të vogla.

Disa vlerësime të përgjithshme për komisionet e monitoruara: Në përgjithësi edhe gjatë kësaj periudhe janë konstatuar të njëjtat probleme si dhe gjatë punimeve të mëparshme të këtij sesi. Krahasuar me punimet e dy kalendareve të para të këtij sesi Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik si dhe Komisioni për Ekonominë dhe Financat ka një rritje të kohëzgjatjes së mbledhjeve si dhe të pjesëmarrjes së deputetëve në mbledhje. Po kështu edhe Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin krahasuar me komisionet e tjera të monitoruara gjatë muajit shtator-tetor ka zhvilluar mbledhje me kohëzgjatje relativisht me të gjatë se mbledhjet e komisioneve të tjera. Gjithashtu, në këtë komision është konstatuar një pjesëmarrje më e gjerë duke përfshirë edhe grupet e interesit, ndërkohe që në komisionet e tjera konstatohet mbështetja vetëm në burimin e informacionit të qeverisë. Ky fakt pengon komisionin për të bërë një vlerësim më të gjerë dhe më të thelluar të çështjeve objekt diskutimi.

Gjatë monitorimit të punimeve të këtij kalendari janë konstatuar përsëri mungesa të shumta të deputetëve në mbledhje si dhe rastet kur deputetët që mungojnë nuk pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjeve të komisioneve sidomos në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

*Lindita Troka
Florjan Kalaja
Klesta Hysi
Ermal Markaj*

RASTE VËZHGIMI: PROCESI I SHQYRTIMIT TË PROJEKTLIGJEVE TË VEÇANTA

(Vijon nga faqja 1)

ar gjithsej 4 mbledhje me një kohëzgjatje në total prej 180 minutash. Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në mbledhjet e komisionit kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e ministrisë së shëndetësisë, përfaqësuesit e OBSH-së në Shqipëri si dhe përfaqësuesit ligjorë të grupeve të interesit kryesisht biznese që tregtojnë duhanin në vendin tonë.

Sipas raportit të përgatitur nga Komisioni të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë ky projektligj synon mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve prej dëmeve të shaktuara nga ekspozimi i pavullnetsëm ndaj tymit të tij. Sipas këtij raporti miratimi i këtij projektligji përbën një hap të rëndësishëm pas ratifikimit nga Kuvendi të Konventës "Për Kontrollin e Duhanit" më 26 prill 2006. Në projektligj janë përfshirë edhe disa rregullime ligjore të direktivave të BE-së lidhur me çështjet e reklamës dhe sponsorizimit të produkteve të duhanit. Duke qenë se duhani është dhe mbetet një nga sfidat e shëndetit publik në realitetin shqiptar komisioni miratoi në parim me unanimitet projektligjin. Gjatë diskutimit nen për nen, duke patur parasysh edhe vërejtjet konkrete të paraqitura nga grupet e interesit, Komisioni propozoi disa amendamente. Pas shqyrtimit nen për nen komisioni i miratoi projektligjin me unanimitetin e anëtarëve të pranishëm duke përfshirë edhe ndryshimet e propozuara.

Si burim informacioni gjatë shqyrtimit të këtij projektligji kanë shërbyer ekspertiza e përfaqësuesve të qeverisë, mendimet dhe sugjerimet e bëra nga grupet e interesit si dhe përvoja e vendeve të tjera. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve në komisione janë marrë parasysh edhe rekomandimet dhe sugjerimet e grupeve të interesit si dhe janë bërë 4 amendamente me objekt hyrjen në fuqi të dispozitave të veçanta. Projektligji është shqyrtuar në dy seanca plenare përkatësisht në seancën e datës 2.11.2006 dhe në seancën e datës 6.11.2006. Kohëzgjatja e shqyrtimit të projektligjit në të dy seancat ka qenë gjithsej 70 minuta. Gjatë shqyrtimit në seancë asnjë nga amendamentet e propozuara nuk është miratuar.

Projektligji ka qenë i parashikuar në rendin e ditës dhe është miratuar në parim me 98 vota pro dhe në tërësi me 86 vota pro në seancën plenare të datës 6.11.2006.

Projektligji "Për Sistemin e Taksave Vendore"

Projektligji "Për Sistemin e Taksave Vendore" është depozituar në Kuvend më datë 13.07.2006 dhe është përfshirë në programin e punimeve të Kuvendit më datë 7.09.2006. Ky projektligj është paraqitur nga Qeveria me propozim të Ministrisë së Financave. Është parashikuar që të shqyrtohet në kalendarin 3-javor të periudhës 25 shtator - 16 tetor 2006 dhe 16 tetor - 6 nëntor 2006. Komisioni përgjegjës për shqyrtimin e këtij projektligji është Komisioni për Ekonominë dhe Financat. Është parashikuar që të japë mendim edhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave më datë 12.09.06 ka zhvilluar mbledhjen e tij të parë me objekt shqyrtimin e projektligjit "Për Sistemin e Taksave Vendore".

Nga ky komision janë zhvilluar gjithsej 4 mbledhje. Njëra prej mbledhjeve të komisionit është zhvilluar para fillimit të seancës plenare në godinën e zhvillimit të seancave. Sipas sekretares së komisionit në këto ambiente nuk lejohen vizitorët dhe si rrjedhojë kjo mbledhje nuk është monitoruar. Kohëzgjatja e 3 mbledhjeve të tjera ka qenë gjithsej rreth 100 minuta punë efektive me objekt shqyrtimin e këtij projektligji.

Si burim informacioni gjatë shqyrtimit të këtij projektligji është shfrytëzuar vetëm ekspertiza e përfaqësuesve të qeverisë, konkretisht specialistë të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Brendshme. Në dy mbledhje ka qenë i pranishëm edhe Zëvendësministri i Financave.

Në asnjë nga mbledhjet e komisionit nuk kanë qenë të pranishëm përfaqësues të grupeve të interesit apo të pushtetit vendor.

Sipas raportit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave ky projektligj synon të integrojë në një ligj të vetëm të gjitha procedurat dhe detyrimet tatimore për biznesin e vogël të cilat aktualisht përcaktohen në tre ligje: ligji nr.8982 datë 12.12.2002 "Për sitemin e taksave vendore" të ndryshuar me ligjin nr.8483 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, Kreu III "Tatimi i ndryshuar mbi fitimin". Projektligji nuk parashikon ndryshime për nivelin e taksave për biznesin e vogël. Një prej ndryshimeve themelore të këtij projektligji është integrimi në një taksë të vetme i taksës vendore për biznesin e vogël dhe i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Niveli i taksave përcaktohet në varësi të kategorisë së rrethit dhe vëllimit të xhiros.

Sipas relacionit shoqërues të projektligjit dhe shpjegimeve të përfaqësuesve të Ministrisë së Financave ky projektligj do të ndikojë në:

- thellimin e reformës së decentralizimit;
- rritjen e autonomisë së organeve të pushtetit vendor duke u dhënë atyre kompetencën për caktimin e nënkatëgorive të bazës së taksës dhe të nivelit të saj në intervalin +/- 30%;
- përmirësimin e administrimit të taksave vendore, pasi rrit interesin dhe përgjegjësinë e bashkive dhe komunave për mbledhjen e të ardhurave dhe për reduktimin e evazionit fiskal;
- rritjen e efikasitetit të administratës tatimore qendrore, duke zvogëluar numrin e taksave që administrohen prej saj.

Për të zvogëluar kohën e nevojshme për kryerjen e procedurave të transferimit të administrimit të taksës nga organet e pushtetit qendror, tek ato të pushtetit vendor, hyrja në fuqi e ligjit parashikohet të jetë më datë 1 janar 2007.

Sipas raportit gjatë diskutimit të projektligjit përfaqësuesit e pozitës vlerësuan pozitivisht synimin e projektligjit për thellimin e decentralizimit fiskal dhe të autonomisë së pushtetit vendor dhe u shprehën për miratimin e tij.

Përfaqësuesit e opozitës kërkuan shtyrjen e shqyrtimit të projektligjit për të siguruar kohën e nevojshme për diskutimin e tij me përfaqësuesit e Qeverisë dhe të organeve të pushtetit vendor. Duke vlerësuar rëndësinë e thellimit të reformave decentralizuese dhe të autonomisë së pushtetit vendor, ata u shprehën se projektligji është një bashkim mekanik i ligjeve ekzistuese fiskale për biznesin e vogël dhe nuk sjell ndonjë risi në këtë drejtim.

Pasi dëgjoi shpjegimet e Zëvendësministrit të Financave, se gjatë hartimit të projektligjit nga Qeveria është marrë edhe mendimi i organeve të pushtetit vendor dhe duke vlerësuar se deputetët kanë pasur kohën e nevojshme prej tre muajsh për konsultimet me institucionet e tjera, Komisioni i miratoi projektligjin me 6 vota pro dhe 5 kundër.

Gjatë shqyrtimit të projektligjeve në komision janë bërë 7 amendamente, ndërsa në seancë 3. Nga këto amendamente 4 kanë qenë thelbësore dhe 6 të natyrës teknike. Projektligji është shqyrtuar në tre seanca plenare përkatësisht në seancën e datës 14.09.06 në të cilën është zhvillur një diskutim për projektligjin rreth 60 minuta. Në seancën e dytë më datë 18.09.06 e cila ka zgjatur 15 minuta projektligji është miratuar në parim. Në seancën e tretë më datë 30.10.2006 e cila ka zgjatur 60 minuta projektligji është shqyrtuar nen për nen dhe është miratuar në tërësi me 75 vota pro. Kohëzgjatja totale e shqyrtimit të projektligjit në të tre seancat plenare ka qenë gjithsej 135 minuta.

PJESË NGA RAPORTI I PROGRESIT PËR SHQIPËRINË I KOMISIONIT EUROPIAN 2006

2. KRITERET POLITIKE

Ky seksion ekzaminon progresin e Shqipërisë në përm-bushjen e kriterëve politike të Kopenhagenit që kërkojnë stabilitet të institucioneve garantuese të demokracisë, shtetin e së drejtës, të drejtat njerëzore dhe mbrojtjen e minoriteteve. Gjithashtu monitoron bashkëpunimin rajonal, marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe respektimin e detyrimeve ndërkombëtare.

2.1. Demokracia dhe shteti i së drejtës

Parlamenti

Roli i parlamentit si një institucion qendror politik vazhdoi të rritet. Marrëdhëniet midis parlamentit dhe organeve të tjera kushtetuese, veçanërisht Gjykatës Kushtetuese dhe Presidencës, si dhe ndërhyrjet pasuese të këtyre organeve, kanë qenë të duhura dhe efikase. Komisionit Parlamentar për Integrimin European ka qenë shumë aktiv, që ka ndihmuar në rritjen e sensibilizimit rreth procesit të integritit european në aktivitetet e parlamentit. Puna efikase plenare dhe e komisionit, i lejoi Parlamentit që të përballonte me sukses ligjin për buxhetin 2006. Puna e parlamentit është tashmë më transparente pasi staf dhe pajisje të specializuara po përdoren për të transkriptuar të gjitha seancat plenare parlamentare.

Periodat e ngërceve politike në pranverën dhe verën e 2006-ës, penguan përpjekjet e parlamentit të merrej siç duhej me çështjet e reformave të rëndësishme, veçanërisht ato që kërkojnë konsensus të gjerë politik. Klima e dobët politike pengoi punën e grupeve parlamentare për reformën zgjedhore dhe marrëveshjet e ngadalta politike vonuan emërimin e anëtarëve në Komisionin Qendror Zgjedhor. Kjo bëri që të vonohej puna për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) të OSBE-së pas zgjedhjeve parlamentare të 2005-ës. Marrëveshja politike e arritur në gusht me ndihmën e komunitetit ndërkombëtar i dha fund ngërçit në verë. Sidoqoftë, Shqipëria duhet të demonstrojë se ka kapacitetet për të arritur një bashkëpunim politik pa ndërhyrjen e jashtme.

Parlamenti vazhdon të përballlet me mangësi teknike dhe administrative. Buxheti i kufizuar i parlamentit nuk përqendrohet në mënyrë konsistente në detyrat thelbësore. Procedurat dhe pajisjet e votimit akoma nuk garantojnë rezultatet transparente dhe të padiskutueshme. Janë ngritur një sërë komitisionesh hetuese *ad hoc*, ndonjëherë me mandat të paqartë. Kjo gjë përbën rrezik duplikimi. Transparenca e parlamentit mund të jetë më transparente nëse transkriptohet edhe puna e komisioneve parlamentare.

Në përgjithësi, parlamenti po merr përipër rolin e plotë politik dhe po bën përmirësim të qëndrueshëm në aspektin teknik. Megjithatë, puna efikase parlamentare mbi reformat thelbësore për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së, është penguar nga bashkëpunimi i vështirë politik.

Qeveria

Qeveria ka miratuar një plan të rishikuar kombëtar për zbatimin e përparësive të Partneritetit European dhe MSA-së. Ky plan është përpjekja e parë për të përcaktuar

një kosto për procesin e integritit european, që është i nevojshëm për parashikimin buxhetor. Plani gjithashtu rendit reformat dhe hapat për krijimin e kapaciteteve dhe u ngarkon përgjegjësitë institucionale. Ky plan do të jetë pjesë e një Strategjie Kombëtare të re për Zhvillimin dhe Integrimin (NSDI). Ka filluar puna për zhvillimin e 23 strategjive sektoriale dhe 10 strategjive të ndërthurura (cross-cutting) për NSDI. Akordimet e fondeve për ministritë e linjës, do të kufizohen në aksionet e përshkruara në 23 strategjitë sektoriale. NSDI do të ushqejë Sistemin e Planifikimit të Integruar (ISP) nëpërmjet të cilit do të akordohen burimet kombëtare dhe të donacioneve. Ky kuadër strategjik dhe operativ mendohet të ndihmojë qeverinë të përmbushë angazhimet për reformat në kuadrin e MSA-së.

Këshilli i Ministrave miratoi ngritjen e Njësisë Integrimi në 12 ministri linje. Ngritja e këtyre njësisë, përmes të cilave Ministria e Integritit European do të koordinojë reformat që kanë lidhje me BE-në, është në proces e sipër. Ministri i Integritit është caktuar Koordinator i Ndihmës Kombëtare IPA.

Stafi i Këshillit të Ministrave është zëvendësuar ndjeshëm me grupe që merret me çështjet e ndërthurura (cross-cutting) drejtpërdrejt nën këshilltarët e Kryeministrit. Kjo strukturë mund të ndihmojë në adresimin horizontal të çështjeve me përparësi të lartë. Janë bërë disa përpjekje për të zgjeruar pjesëmarrjen në hartimin e ligjeve të reja përtej qeverisjes qendrore deri te aktorët vendorë dhe të shoqërisë civile, për shembull për projekt-ligjin për huat për pushtetin vendor (bashkitë).

Megjithatë, mbetet shumë për t'u bërë për të siguruar konsensus më të gjerë dhe shfrytëzimin e të gjithë ekspertizës së disponueshme për reformat. Ekipet e reja horizontale që punojnë drejtpërdrejt për Kryeministrin, jo gjithmonë kanë marrë në konsideratë ekspertizën qeveritare dhe donatore në hartimin e propozimeve legjislative, duke rezultuar në hartime të dobëta. Po shtohet numri i institucioneve drejtpërdrejt nën Këshillin e Ministrave, dhe shihet një prirje për vëzhgim të drejtpërdrejt nga ana e Kryeministrit. Ky centralizim ka çuar në marrjen e shumë vendimeve teknike rutinë shumë vendime teknike në nivelin e Kryeministrit, çka ka vonuar aksionet kyçe.

Zbatimi i IPS aktualisht koordinohet nga Departamenti i Koordinimit të Strategjive dhe Ndihmës së Huaj në Këshillin e Ministrave. Megjithatë, numri i plotë i personelit për Njësinë e Zbatimit të IPS nuk është caktuar akoma, pavarësisht një plani të përmirësuar të stafit. Koordinimi i shëndoshë ndërmjet Departamentit të Koordinimit të Strategjive dhe Ndihmës së Huaj dhe Ministrisë së Integritit European do të jetë vendimtar, sidomos në garantimin e mbështetjes së duhur për angazhimet për reformat MSA.

Administrata publike

Qeveria e re ka bërë ndryshime të konsiderueshme në administratën publike. Ndryshimet thelbësore të stafit janë bërë për të adresuar korrupsionin, sidomos në dogana dhe tatime. Portofolet ministrore

(Vijon në faqen 6)

PJESË NGA RAPORTI I PROGRESIT PËR SHQIPËRINË I KOMISIONIT EUROPIAN 2006

(Vijon nga faqja 5)

janë ndryshuar: për shembull Ministrinë e Rendit Publik dhe e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, janë integruar në një Ministri të re të Brendshme. Gjithashtu shumë Ministri janë ristruktuar për të përmirësuar koordinimin dhe efikasitetin, si në rastin e Ministrisë së Integritetit Europian. Tashmë kjo Ministri i ka ambientet e nevojshme.

Megjithatë, punësimi dhe shkarkimi i stafit në disa raste është bërë pa i kushtuar vëmendjen e duhur Ligjit për Shërbimin Civil. Aktet administrative janë firmosur nga zëvendësues të përkohshëm që nuk ishin emëruar zyrtarisht. Të dy këto zhvillime kanë minuar në njëfarë mase sigurinë ligjore të parashikuar nga Ligji për Shërbimin Civil. Futja e strukturave të reja dhe stafit të ri ka çuar në pakësimin tranzitor të kapaciteteve në disa segmente të administratës publike. Shqipëria tashmë duhet që mbi këto ndryshime të forcojë efikasitetin e administratës publike. Kapaciteti i Departamentit të Administratës Publike për vendosjen e strategjive menaxhuese në administratën publike, mbetet i kufizuar. Strukturat e karrierës, planifikimit të karrierës, rrogat dhe menaxhimi i performancës në shërbimin civil dhe shërbimet e tjera publike, mbeten të dobëta. Emërimet politike të nëpunësve të lartë vazhdojnë të jenë në masë, duke e kufizuar rritjen e shërbimit civil në nivel profesioniste të larta.

Sistemi gjyqësor

Ligji i ri për rregullimin e organizimit të gjyqësorit është miratuar nga Këshilli i Ministrave. Qëllimi ishte përmirësimi i strukturës së karrierës së gjyqtarëve, qartësimi i procedimeve disiplinore dhe caktimi me short (rëndom) i çështjeve të gjyqtarët. Kapacitetet e Zyrës së Administratës së Buxhetit Gjyqësor, janë përmirësuar. Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka miratuar një sistem të ri për vlerësimin profesional të gjyqtarëve të gjykatave të ulëta. Po fillon puna për një ndërtesë të re ku të strehohen gjykatat e rretheve dhe të apelot për krimet e rënda në Tiranë.

Një vendim i Gjykatës Kushtetuese nënvizoi pavarësinë e gjyqësorit. Një ligj i ri me qëllim eliminimin e konfliktit të interesave në Këshillin e Lartë të Drejtësisë (organi i pavarur që emëron/cakton gjyqtarët) kërkonte që anëtarët e tij, shumica e tyre gjyqtarë, të heqin dorë nga profesioni. Kjo i privoi gjashtë gjykata nga gjyqtarët e tyre, duke e ngadalësuar punën e gjykatave për disa muaj. Më pas, Gjykata Kushtetuese e shpalli jokushtetuese pjesën më të madhe të ligjit të ri.

Transparenca gjyqësore është rritur me publikimin e më shumë vendimeve gjyqësore dhe rezultatet e kontroleve për shkelje të kodit të procedurës. Ekranet që shfaqin informacione për seancat gjyqësore janë vendosur në hollet e disa gjykatave, si dhe zyrat e gjykatave janë vënë më afër hyrjeve publike.

Shkolla e Magjistraturës i ka zgjeruar programet trajnuese. Ajo mbetet një pikë fokale e rëndësishme për trajnimin fillestar dhe vazhdues dhe është burimi për thujtë të gjithë prokurorët e rinj dhe gjyqtarët. Strategjia afatgjatë e saj thekson se Shkolla do të jetë e qëndrueshme pa mbështetje donatore, nëse vazhdonte mbështetja nga qeveria.

Është bërë njëfarë progresi në fushën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nëpërmjet ristrukturimit të Shërbimit të Përmbarrimit dhe rritjes së nivelit të punonjësve të tij.

Megjithatë, procedimet gjyqësore mbeten të zgjatura, të organizuara dobët e me mungesë transparence. Ligji i ri i propozuar për Gjyqësorin nuk adreson tre aspekte: rritjen e pavarësisë dhe mbrojtjen kushtetuese të gjyqtarëve, rritjen e pagave dhe statusit të stafit administrativ të sistemit gjyqësor (që s'janë nëpunës civilë) dhe ndarjen e duhur të kompetencave midis inspektorave gjyqësore të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë. Dy inspektoratet aktualisht e ndajnë punën në mënyrë

jozyrtare. Dispozitat e propozuara për caktimin transparent të çështjeve do të kërkojnë legjislacion zbatues për të vendosur rregulla objektive. Ende s'është ngritur një sistem për vlerësimin e prokurorëve. Kërkohej zbatimi i ristrukturimit të planifikuar të gjykatave të rretheve për të përmirësuar eficientë, por s'ka filluar akoma. Shumë gjykatave ende iu mungon hapësira e nevojshme për salla gjyqi, zyra gjyqtarësh, arkiva dhe pajisje. Bashkëpunimi midis policisë dhe gjyqësorit mbetet i dobët. Shërbimi i Përmbarrimit pengohet në ekzekutimin e gjykimeve nga mungesa e fondeve, vendimet e paqarta gjyqësore dhe refuzimi i shumë organizatave qeveritare të përmbushin detyrimet e tyre për gjykimet.

Projekt-Ligji për Gjyqësorin kërkon që të gjithë gjyqtarët e rinj të jenë të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës, por asnjë hap tjetër nuk është marrë në emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve nëpërmjet konkurseve të drejta. Zgjerimi i mundësive akademike për studimin e të drejtës, do të kërkojë një sistem të përshtatshëm të kontrollit cilësor. Profesionit dhe avokatit vazhdojnë të jenë pika të dobëta në sistemin gjyqësor, me pak zhvillime ligjore apo praktike.

Transformimi i Komisionit të Reformës Ligjore nga organ me orar të plotë në organ me orar të pjesshëm, kërcënon pakësimin e kapaciteteve për të siguruar koherencën e ligjeve të reja dhe përputhjen e tyre me kuadrin ligjor europian dhe ndërkombëtar, e për të siguruar pjesëmarrjen dhe informimin e publikut.

Mungojnë përpjekjet e mëtejshme për zhvillimin e kuadrin ligjor për mbrojtjen e dëshmitarëve që ato të garantojnë balancimin e sigurisë së dëshmitarëve vulnerabël me të drejtën për mbrojtje të të akuzuarit. Ka plane për t'i kushtuar një drejtori të plotë policore mbrojtjes së dëshmitarëve, por ende mungojnë burimet e mjaftueshme për zbatimin e plotë të legjislacionit ekzistues. Masave themelore për mbrojtjen e dëshmitarëve, si mbrojtja e dëshmitarëve në gjyq apo përdorimi i ekranëve apo televizionit me qark të mbyllur, nuk u kushtohet vëmendje e mjaftueshme. S'është bërë progres në udhëzimet operative për mbrojtjen e dëshmitarëve. Nisur nga fshehtësia dhe ndjeshmëria e mbrojtjes së dëshmitarëve, stabiliteti dhe vazhdimësia e kompletimit me staff në sektor kërkon vëmendje më të madhe.

(Vijon në faqen 7)

PJESË NGA RAPORTI I PROGRESIT PËR SHQIPËRINË I KOMISIONIT EUROPIAN 2006

(Vijon nga faqja 6)

Një komision i veçantë hetues i parlamentit rezultoi në votim që i rekomandonte Presidentit të shkarkojë Prokurorin e Përgjithshëm. Rrjedhimisht Presidenti e hodhi poshtë këtë rekomandim. Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti me pëlqimin e Kuvendit.

Siguria ligjore është thelbësore në progresin e reformave në Shqipëri dhe është një parakusht i rëndësishëm për një numër detyrimesh nën MSA-në. Në veçanti, miratimi i kuadrove efikase ligjore është i rëndësishëm për tregtinë e suksesshme nën Marrëveshjen e Ndërmjetme dhe MSA-në.

Politika anti-korrupsion

Qeveria ka ndërmarrë masa të vendosura për uljen e korrupsionit, sidomos në shërbimet tatimore dhe doganore ku problemet ishin më të rënda. Kjo gjë adreson një përparësi kyçe të Partneritetit Europian. Shkarkimet në masë janë bërë për të rimarrë kontrollin e departamenteve ku korrupsioni ishte mjaft i përhapur. Kjo rezultoi në disa përmirësime, veçanërisht në dogana.

Qeveria gjithashtu është përpjekur të adresojë korrupsionin duke pakësuar rolin e shtetit në jetën ekonomike dhe sociale të vendit, nëpërmjet zvogëlimit të stafit të administratës qendrore dhe thjeshtimit të procedurave administrative dhe licencuese. Qeveria ka propozuar reforma në administratën tatimore, prokurimin publik dhe regjistrimin e bizneseve për uljen e korrupsionit dhe përmirësimin e klimës për bizneset.

Numri i zyrtarëve publikë të përndjekur për korrupsion, është rritur. Nga 237 të përndjekur në 2005 dhe 75 në tremujorin e parë të 2006-ës (krahasuar me 171 në 2004), 84 janë ndëshkuar, përfshi zyrtarë të nivelit të mesëm dhe të lartë. Pavarësisht frikës se ndryshimet e stafeve mund të përdoren si armë politike, butësi nuk është treguar karshi atyre të anëtarësuar në partinë në pushtet. Numri i procedimeve disiplinore kundër prokurorëve të korruptuar, është tregues i shkallës së korrupsionit, por sinjal pozitiv që po bëhen hapa për ta luftuar (71 raste që në 2002, dmth. 25-30% i numrit total të prokurorëve në Shqipëri)

Qeveria ka ngritur një Task Forcë Anti-korrupsion të kryesuar nga Kryeministri. Ajo përbëhet nga ministrat e linjës dhe kryetarë të agjencive të ndjeshme qeveritare si për tatimet, privatizimin, licencimin dhe prokurimin publik. Ajo analizon dhe vlerëson problemet e korrupsionit në sektorë specifike dhe formulon përparësi strategjike dhe masa praktike. Stazhi i anëtarëve të saj i jep autoritet që të ndërmarrë ndryshime të vërteta. Grupi Monitorues Anti-Korrupsion është shkruar në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe është riquajtur Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Anti-Korrupsionit. (DIAC), që operon nën zyrën e Kryeministrit dhe përbëhet nga një drejtor dhe 10 inspektore të cilët analizojnë çështjet e raportuara të korrupsionit në gjitha degët e administratës publike. Ata propozojnë masa administrative ose dërgojnë pëshqjet për hetim penal.

Ligji për Konfliktin e Interesave është amenduar për të adresuar problemet praktike që rezultuan nga zbatimi i ligjit ekzistues. Inspektorati i Lartë për Zbulimin dhe

Verifikimin e Pasurive e ka intensifikuar aktivitetin dhe zyrtarët e inspektoratit tashmë janë autorizuar të hetojnë llogaritë bankare të zyrtarëve jashtë Shqipërisë. Task forca e prokurorëve të përzgjedhur dhe oficerëve të policisë gjyqësore e ngritur në gjykatën e rrethit të Tiranës, tashmë merret me çështjen e korrupsionit ashtu edhe me krimet financiare.

Hapa janë marrë për rritjen e transparencës së administratës publike: publikime në internet të urdhrave qeveritare, vendimeve dhe akteve të tjera publike; njësitë e informimit në ministri, linjat e lira telefonike dhe kutitë postare për komentet publike mbi institucionet qendrore. Shqipëria merr pjesë në dy nisma rajonale anti-korrupsion: GRECO e Këshillit të Europës (Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit) dhe SPAI (Nisma Anti-Korrupsion të Paktit të Stabilitetit). Zbatimi i rekomandimeve të Raportit Vlerësues të GRECO-s, ka qenë i kufizuar. Qeveria ka ndjekur një qasje të re më tepër se të përdorë kuadrin e Strategjisë Kombëtare Anti-Korrupsion që nuk është përditësuar. Ligji i ri për nxitjen e qytetarëve që të denoncojnë korrupsionin në administratën publike, vë në veprim rekomandimin "whistle-blowing" të GRECO-s. Megjithatë, kjo ka rritur shqetësimet se denoncimet mund të përdoren për larje hesapesh.

Disa masa legjislative të projektuara për të luftuar korrupsionin, janë hedhur poshtë nga Gjykata Kushtetuese në bazë të shqetësimeve për të drejtat individuale (për shembull një ligj kundër nepotizmit në administratën doganore dhe tatimore). Një propozim i qeverisë për të hequr imunitetin e anëtarëve të deputetëve me qëllim ndjekjen ligjore për korrupsion, ka mbetur ende varur në parlament pasi kërkohet një shumicë 3/5 parlamentare dhe opozita e kundërshton mbi baza kushtetuese.

Ligje të reja kërkohen nga Shqipëria për të zbatuar Konventën e Ligjit Civil për Korrupsionin dhe Konventën e Ligjit penal për Korrupsionin, Konventën Anti-Korrupsion të OKB-së dhe Konventën e OKB-së kundër Krimit të Organizuar trans-kombëtar (Konventa e Palermos që përmban dispozita për korrupsionin), zhvillimi i të cilave është vonuar. Shqipëria ende nuk ka legjislacion specifik mbi mitmarrjen nga ana e zyrtarëve të huaj dhe nuk është vend palë në Konventën e OECD-së për Luftën kundër Mitmarrjes nga Zyrtarët e Huaj Publikë në Transaksione Ndërkombëtare Biznesi.

Progresi i qëndrueshëm në luftën kundër korrupsionit është një kusht thelbësor për zbatimin e suksesshëm të MSA-së dhe Marrëveshjes së Ndërmjetme. Kjo do të kërkojë pasimin e masave të forta fillestare me përpjekje sistematike për të kufizuar shkaqet e korrupsionit nëpërmjet mbushjes së boshllëqeve ligjore, përmirësimit të rrogave, stabilizimit të administratës publike, thjeshtimit të mëtejshëm të procedurave të ndërlikuara e të paqarta administrative si dhe përmirësimi i profesionalizmit i nëpunësve civile. Hartimi dhe miratimi i legjislacionit efikas për reformat sistematike që nevojiten se si të luftojë korrupsionin në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

NGA MBLEDHJET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR MUAJIN NËNTOR 2006

I. MBLEDHJE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE datë 01.11.2006

VENDIME për propozim projektligjesh

1. Për propozimin e projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8551, datë 18.11.1999, "Për Avokaturën e Shtetit"
2. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8551, datë 18.11.1999, "Për Avokaturën e Shtetit"
3. Për propozimin e projektligjit "Për ratifikimin e Marrëveshjes shumëpalëshe, ndërmjet Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të Aviacionit Europian"
4. Për ratifikimin e Marrëveshjes shumëpalëshe, ndërmjet Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të Aviacionit Europian".
5. Për ratifikimin e ndryshimit në marrëveshjen e rishitjes së Aksioneve të INSIG, SHA-së, ndërmjet Ministrisë së Financave, që vepron në emër të Shtetit Shqiptar, dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD)
6. Për ratifikimin e një ndryshimi në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), në emër të institucioneve të përkohëshme vetëqeverisëse të Kosovës.

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 01.11.2006

1. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për realizimin e Studim-Projektimit të Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës "Arbnori" dhe kthimin e saj në teatër kombëtar dhe Galeri Kombëtare të Arteve.
2. Për miratimin, në parim, të marrëveshjes ndërmjet këshillit të Ministrave dhe Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Polonisë, për bashkëpunim ekonomik.
3. Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtëshme, pronë private, që prek-

en nga ndërtimi i nënstacionit 220/110/35/20 KV, Koplik, Malësi e Madhe.

4. Për fillimin e procedurave për mbylljen e kontratës së koncesionit, për ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizimeve, Elbasan, dhe lejimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë, dhe Energjitikës të blejë 100 për qind të aksioneve të shoqërisë "BERLINËASSER INTERNATIONAL, GmbH", në "ELBER", SHPK
5. Për miratimin e studimit "Për mundësinë e ndërtimit të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL) dhe të infrastrukturës përkatëse, në bregdetin e qarkut të Fierit"
6. Për disa ndryshime në Vendimin nr.622, datë 12.11.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për Përcaktimin e zonave, ku mund të hapen kazino", të ndryshuar.
7. Për propozimin e projektligjit "Për ratifikimin e ndryshimit në marrëveshjen e rishitjes së aksioneve të INSIG, SHA-së, ndërmjet Ministrisë së Financave, që vepron në emër të shtetit Shqiptar, dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) e Bankës Europiane për rindërtim dhe Zhvillim (EBRD)"
8. Për propozimin e projektligjit "Për ratifikimin e një ndryshimi në marrëveshjen e Tregtisë së Lirë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Administratës së përkohëshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), në emër të institucioneve të përkohëshme vetëqeverisëse të Kosovës".

II. MBLEDHJE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE datë 09.11.2006

VENDIME për propozim projektligjesh

1. Për propozimin e projektligjit "për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), që lidhet me marrëveshjen e kredisë, ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe (EBRD), në kuadër të Programit të Komunitetit të Energjisë së Europës Juglindore".
2. Për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), që lidhet me marrëveshjen e kredisë, ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), në Kuadër të programit të komunitetit të Energjisë së Europës Juglindore.

VENDIME të Këshillit të Ministrave datë 09.11.2006

1. Për dhënie shtesë fondi disa njësive të qeverisjes vendore, për marrjen e masave për parandalimin e emergjencave civile dhe për rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara, në pronën publike dhe mjedisin, si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 652, datë

(Vijon në faqen 9)

NGA MBLEDHJET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR MUAJIN NËNTOR 2006

(Vijon nga faqja 8)

27.9.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për një shtesë fondi disa njësive të qeverisjes vendore, për rehabilitimin e infrastrukturës së dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore, si dhe marrjen e masave për përballimin e emergjencave civile".

2. Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së republikës së Italisë, për realizimin e një qendre shërbimesh dhe të një rrjeti telematik për universitetet.

3. Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së veçantë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Suedisë, për projektin e mbështetjes së menaxhimit të shpenzimeve publike, faza III.

4. Për transferim dhe shtesë fondesh në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.

5. Për një shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për financimin e projektit të UNESCO-S, "Restaurimi i qendrës historike të Gjirokastrës".

6. Për një ndryshim në vendimin nr.711, datë 27.12.2001, të Këshillit të Minsitrave, "Për strukturat dhe nivelet e pagave të nënpunësve civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së presidentit dhe Kuvendit dhe disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", ndryshuar me vendimet nr.39, datë 26.1.2001, nr.158, datë 22.3.2001, nr.167, datë 30.3.2001, nr.174, datë 30.3.2001, nr.197, datë 6.4.2001, nr.358, datë 31.5.2001, dhe nr. 424, datë 11.6.2001, të këshillit të Minsitrave", të ndryshuar.

7. Për lejimin e kalimit tranzit të disa trupave ushtarake Sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.

8. Për një ndryshim në Vendimin nr.37, datë 28.1.2002, të këshillit të Minsitrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Repartit të Inspektim-Shpëtim-Miniera".

9. Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 198, datë 5.4.2006, të këshillit të Minsitrave, "Për pranimet në Universitetet dhe shkollat e larta, për vitin akademik 2006-2007, në sistemin me kohë të plotë, dhe për përcaktimin e tarifës së shkollimit, në sistemin me kohë të plotë", të ndryshuar.

10. Për procedurat e mbledhjes, të përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuar gjatë procesit të njohjes, kthimit apo kompensimit të pronës.

11. Për përcaktimin e çmimit të shitjes së truallit, pronë shtetërore, familjeve që trajtohen me strehim nga shteti.

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Miratimin e Formës dhe të Formulës së Privatizimit të INSIG SHA-së"

Përcaktimi i formës dhe i formulës së privatizimit të INSIG, sha-së, është bërë edhe në vitin 2002, me ligjin nr.8899, datë 22.5.2002, "Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të INSIG, sha-së", por procesi i privazimit nuk u zhvillua. Meqenëse ky ligj tashmë e ka humbur fuqinë juridike, për shkak të tejkalimit të afateve ligjore, të parashikuara në ligj për privatizimin e pjesës së aksioneve të shtetit shqiptar në këtë shoqëri, u hartua dhe paraqitet për miratim ky projektligj, për përfundimin e procesit të privatizimit të kësaj shoqërie.

E veçanta në përmbajtjen e këtij projektligji qëndron në faktin se 61% e aksioneve të INSIG, sha-së, që janë pjesë e shtetit shqiptar, do t'u shiten, përmes procedurës "Tender i hapur ndërkombëtar", investitorëve strategjikë të huaj, në monedhë të huaj.

Gjithashtu, për të bërë vlerësimin e çmimit të këtyre aksioneve, do të përzgjidhet, përmes tenderit ndërkombëtar, një vlerësues ndërkombëtar.

Theksojmë se nëse tre vjet pas përcaktimit të investitorit ndërkombëtar do të mbetet pjesë aksionesh të pashitura, atëherë kjo pjesë do t'u shtitet subjekteve private vendase, në monedhën e vendit.

Përsheptimi i procedurave të privatizimit të INSIG,sha-së, do të ndikonte pozitivisht në zhvillimin ekonomik të vendit.

PROJEKTLIGJ

PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE TË FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË INSIG, SHA-SË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

Neni 1

Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i formës dhe i formulës së transferimit të aksioneve, që zotëron shteti shqiptar në shoqërinë tregtare "INSIG", sha, dhe i të drejtave të lidhura me to.

Neni 2

Forma e privatizimit

Forma e transferimit të 61 për qind të aksioneve të shoqërisë tregtare, INSIG, sha, të cilat zotërohen nga shteti shqiptar, është transferimi me anë të shitjes, në favor të investitorëve strategjikë, nëpërmjet procedurës "Tender i hapur ndërkombëtar", sipas formulës së parashikuar në nenin 3, të këtij ligji.

"Investitor strategjik" nënkupton shoqërinë e huaj të sigurimeve të njohur në tregun ndërkombëtar të sigurimeve, jorezidente në territorin e Republikës

(Vijon në faqen 10)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Miratimin e Formës dhe të Formulës së Privatizimit të INSIG SHA-së"

(Vijon nga faqja 9)

së Shqipërisë, e cila nuk është themeluar sipas ligjit shqiptar, por që ka qenë e suksesshme në treg dhe është në gjendje të demonstrojë e të përmbushë kapacitetet e kërkuara për zhvillimin e INSIG-ut, duke kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të tregut të sigurimeve në Shqipëri.

Neni 3

Formula e privatizimit

Për 39 për qind të aksioneve të INSIG-ut që u janë transferuar BERZH-it dhe IFC-së, nëpërmjet shitjes, të zbatohen dispozitat e ligjit, që ka miratuar marrëveshjen e transferimit të këtyre aksioneve, si dhe të ligjit, që përcakton të drejtat për rishitje.

Struktura e formulës së privatizimit të INSIG, sha-së, është, si më poshtë vijon:

1. 61 për qind e aksioneve iu ofrohen për shitje investitorëve strategjikë, të cilët përzgjidhen në bazë të procedurave të përcaktuara nga Ministria e Financave, me tender të hapur ndërkombëtar, brenda datës 31 dhjetor 2007.

2. Nëse aksionerët e tjerë të INSIG, sha-së, vendosin të transferojnë të drejtën e pronësisë së aksioneve të tyre tek i njëjti investitor strategjik, i përzgjedhur me procedurat e zhvilluara nga Ministria e Financave, për transferimin e të drejtave të lidhura me aksionet e zotëruara prej tyre, të zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 4

Vlerësimi i çmimit dhe përzgjedhja e vlerësuesit

Vlera e të drejtave të lidhura me aksionet, me të cilën do të fillojnë negociatat për shitjen e tyre, bëhet nga një vlerësues ndërkombëtar, i njohur në këtë fushë. Kjo vlerë miratohet nga Këshilli i Ministrave, i cili miraton edhe kriteret e veçanta dhe marrëveshjen për transferimin e të drejtave të lidhura me aksionet e zotëruara nga shteti shqiptar në shoqërinë INSIG, sha.

Përzgjedhja e vlerësuesit ndërkombëtar bëhet me tender të hapur ndërkombëtar, ndërsa, në rastin e shitjes edhe të aksioneve të zotëruara nga BERZH-i dhe IFC-ja, përzgjedhja bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve.

Neni 5

Monedha e pagesës

Transferimi i aksioneve, në favor të investitorëve, të përzgjedhur sipas këtij ligji, bëhet në një monedhë të huaj, sipas përcaktimit të bërë nga Ministri i Financave

Neni 6

Aksionet e mbetura

Kur pas përzgjedhjes dhe transferimit, sipas këtij ligji, të aksioneve në favor të investitorëve strategjikë, do të kenë mbetur aksione të pashitura,

ato u shiten, me ofertë publike, subjekteve private shqiptare, brenda tri vjetëve nga data e transferimit të aksioneve, në favor të investitorëve strategjikë. PAGESA për shitjen e aksioneve subjekteve private shqiptare bëhet në monedhën vendase.

Neni 7

Detyrimet e investitorëve

Investitorët, pjesëmarrës në procesin e shitjes së aksioneve të zotëruara nga shteti shqiptar në INSIG, sha, duhet të respektojnë kërkesat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe, në mënyrë të veçantë, kërkesat e parashikuara nga legjislacioni tregtar dhe ai i sigurimeve në Republikën e Shqipërisë.

Investitorët e përzgjedhur sipas këtij ligji, për zotërimin e aksioneve të shoqërisë INSIG, sha, duhet të bien dakord, paraprakisht, për të miratuar çdo ndryshim të nevojshëm në statutin e INSIG, sha-së., për nënshkrimin e aksioneve të shoqërisë nga aksionerët e rinj, siç parashikohet në këtë ligj, dhe të mbrojnë të drejtat e aksionerëve., në minorancë, të shoqërisë, sipas standardeve bashkëkohore të drejtimit të përbashkët.

Neni 8

Zbatimi i privatizimit

Ministria e Financave, në bashkëpunim me BERZH-in dhe IFC-në, të cilave u janë transferuar 39 për qind të aksioneve, të kryejë procedurat e privatizimit të INSIG, sha-së, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 9

Nxjerrja e akteve

Ngarkohet Këshilli i Ministrave, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 10

Zgjidhja e investimeve

Ngarkohet Ministria e Financave, që, përpara procesit të transferimit të aksioneve të zotëruara nga shteti shqiptar në INSIG, sha, të paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave, aktet e nevojshme nënligjore, për zgjidhjen e problemeve të investimeve të kryera nga INSIG, sha-ja, për rritjen e vlerës së shitjes së këtyre aksioneve.

Neni 11

Shfuqzime

Ligji nr.8899, datë 22.5.2002, "Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të INSIG, sha-së", shfuqizohet.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 1)

5. P/ ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7643, date 2.12.1992 “Për Inspektoriatin Sanitar Shtetëror”.

Për votim:

1. P/vendim “Për zgjatjen e afatit të Komisionit për Reformën Zgjedhore”.

2. P/ ligji “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”.

3. P/ Ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8618, date 14.6.2000 “Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”.

4. P / ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, date 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.

5. P/ ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në disa ligje organike”.

Veprimtari në Komisione – nga data 7 – 23 Nëntor 2006.

1. P/ ligji “Për ratifikimin e Planit të Veprimit të Programit Kombëtar 2006 – 2010, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për popullsinë (UNEPA).

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut.*

· *Komisioni i Jashtëm.*

· *Komisioni i Integritetit.*

· *Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë.*

2. P/ Ligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Aktin e Hagës, të marrëveshjes së Hagës, për regjistrimin ndërkombëtar të projekteve industriale, 1960”.

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut.*

· *Komisioni i Jashtëm.*

· *Komisioni i Integritetit.*

· *Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.*

3. P/ Ligji “Për ratifikimin e Konventës, së Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore”.

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike*

dhe të Drejtave të Njeriut.

· *Komisioni i Jashtëm.*

· *Komisioni i Integritetit.*

· *Komisioni i Sigurisë Kombëtare.*

4. P/ Ligji “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin e terrorizmit”.

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën*

Publike dhe të Drejtave të Njeriut.

· *Komisioni i Jashtëm.*

· *Komisioni i Integritetit.*

· *Komisioni i Sigurisë Kombëtare.*

5. P/ Ligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës, të Marrëveshjes së Hagës, për regjistrimin ndërkombëtar të projekteve industriale dhe rregulloret mbështetur në aktin e Gjenevës”.

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën*

Publike dhe të Drejtave të Njeriut.

· *Komisioni i Jashtëm.*

· *Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.*

6. P/ ligji “Për ratifikimin e Protokollit nr.13, të Konventës Europiane, për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe lirive themelore, për heqjen e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat”.

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën*

Publike dhe të Drejtave të Njeriut.

· *Komisioni i Jashtëm.*

· *Komisioni i Integritetit.*

· *Komisioni i Sigurisë Kombëtare.*

7. P/ Ligji “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin, kërkimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”.

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën*

Publike dhe të Drejtave të Njeriut.

· *Komisioni i Jashtëm.*

· *Komisioni i Sigurisë Kombëtare.*

8. P/ ligji “Për buxhetin e Shtetit, të vitit 2007”.

· *Komisioni përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat.*

· *Komisionet e Përhershme.*

9. P/ ligji “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”.

· *Komisioni përgjegjës: Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

(Vijon në faqen 12)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 11)

· *Jep mendim: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut.*

10. P/ ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9323, date 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar.

· **Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë**

11. P/ ligji “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në punë të vështira”. (grup deputetësh).

Është shtyrë në seancën e datës 1.06.2006 për ta shqyrtuar edhe Komisioni i Ekonomisë dhe Financës.

12. P/ ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

· **Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë**

· **Komisioni i Ligjeve, Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut**

13. P/ ligji “Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të INSIG, SHA-së”.

· **Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**

· **Jep Mendim: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**

14. P/ ligji “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

· *Komisioni Përgjegjës: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

15. P/ ligji “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”.

· *Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë*

16. P/ ligji “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”.

· *Komisioni Përgjegjës: Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

17. P/ ligji “Për pastërtinë e figurave të zyrtarëve të lartë të administratës dhe të zgjedhurve”. (Depozituar nga grupi parlamentar i PD-së).

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

18. P/ ligji “Për verifikimin e të qenit bashkëpunëtor të shërbimeve sekrete shqiptare para datës

31.12.1992, të funksionarëve të lartë publikë”. (Depozituar nga grupi parlamentar i PS-së).

19. P/ ligji “Për kontrollin e figurës së personit zyrtar të zgjedhur apo emëruar në organe të rëndësishme të shtetit”. (Depozituar nga deputeti Nard Ndoka).

20. P/ ligji “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

· *Komisioni Përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat*

· *Jep Mendim: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

21. P/ ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8607, datë 27.04.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, të ndryshuar.

22. P/ Ligji “Për Prokurimet Publike”.

· *Komisioni Përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat*

· *Jep Mendim: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

23. P/ Vendim “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).

· *Komisioni përgjegjës: Komisioni Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik*

· *Jep mendim: Komisioni i Ekonomisë dhe Financës.*

24. P/Rezolutë për Kosovën.

· *Komisioni përgjegjës: Komisioni për Politikën e Jashtme*

25. P/Rezoluta “Për naftësjellësin AMBO”.

· **Komisioni Përgjegjës: Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.**

· **Jep Mendim: Komisioni për Ekonominë dhe Financat**

E enjte, datë 9.11.2006, ora 10.⁰⁰

- Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60’).

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, datë 6.11.2006.

3. P/ ligji “Për ratifikimin e Planit të Veprimit të Programit Kombëtar 2006 – 2010, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për popullsinë (UNEPA).

(Vijon në faqen 13)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 12)

4. P/ ligji "Për ratifikimin e Protokollit nr.13, të Konventës Europiane, për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe lirive themelore, për heqjen e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat".

5. P/ ligji "Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë".

E hënë, datë 13.11.2006, ora 17.00

- **Seancë Plenare**

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, datë 9.11.2006.

3. Paraqitja e raportit të Këshillit të Legjislacionit për procedurën e shkarkimit të Kryetares së Kuvendit.

4. P/ ligji "Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007" (në parim).

E enjte, datë 16.11.2006, ora 10.00

- **Seancë Plenare**

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare datë 13.11.2006.

3. P/ ligji "Për ratifikimin e Konventës, së Këshillit të Europës "Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore".

4. P/ ligji "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për parandalimin e terrorizmit".

5. P/ ligji "Për Prokurimet Publike".

6. P/ ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9323, date 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar.

7. P/ ligji "Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

8. Shqyrtimi i p/rezolutës "Për Kosovën".

E hënë, datë 20.11.2006, ora 17.00

- **Seancë Plenare**

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare datë 16.11.2006.

3. P/ ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës, të Marrëveshjes së Hagës, për regjistrimin ndërkombëtar të projekteve industriale dhe rregulloret mbështetur në aktin e Gjenevës".

4. P/ ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Aktin e Hagës, të marrëveshjes së Hagës, për regjistrimin ndërkombëtar të projekteve industriale, 1960".

5. P/ ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".

6. P/ ligji "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë".

7. Shqyrtimi i p/rezolutës "Për naftësjellësin AMBO".

E enjte, datë 23.11.2006, ora 10.00

- **Seancë Plenare**

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, datë 20.11.2006.

3. P/ ligji "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për parandalimin, kërkimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit".

4. P/ ligji "Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të INSIG, SHA-së".

5. P/ ligji "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi".

6. P/ ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8607, datë 27.04.2000 "Statusi i Dëshmorit të Atdheut", të ndryshuar.

E hënë, datë 27.11.2006, ora 10.00

- **Seancë Plenare**

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, datë 23.11.2006.

3. P/ ligji "Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007" (nen për nen).

4. P/ Vendim "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).

Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator
Qendra e Studimeve Parlamentare/
Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdp.org